



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Të nxënit

Ngarkesa: 3kredite;40 orë mësimore; 30 leksione /15seminare

Viti / Semestri :Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master “Mësuesi”

Kodi i etikës: Kodi i etikësi UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithsme lëndore:

Kjo lëndë synon të zhvillojë te studentët aftësinë: për të identifikuar dhe për të zbatuar konceptet dhe teoritë e ndryshme të të nxënit në situata praktike; për të zgjedhur dhe zbatuar metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënies në situata praktike; për të zgjedhur dhe zbatuar metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënies në mbështetje dhe nxitje të procesit të të nxënit; për të përshtatur metodologjitë e tyre mësimore në përputhje me teoritë e të nxënit; për të krijuar një mjedis të nxëni tërheqës dhe efektiv, i cili lehtëson procesin dhe inkurajon pjesëmarrjen aktive të nxënësve

Objektivat specifikë lëndorë:

Studentët janë në gjendje:

1. Të reflektojnë në mënyrë kritike mbi stilin e tyre të mësimdhënies dhe metodat e aplikuara dhe t'i përmirësojnë ato vazhdimisht;
2. Të përshtatin me fleksibilitet metodat dhe strategjitë e tyre të mësimdhënies në përshtatje me nxënësit dhe kontekstet e ndryshme mësimore;
3. Të përmbushin nevojat e ndryshme të nxënësve dhe të diferencojnë materialet dhe strategjitë e të nxënit në përputhje me to.

Rezultate të pritshme:

Kjo lëndë trajton teoritë dhe modelet themelore të procesit të të nxënit duke i ardhur në ndihmë studentëve të identifikojnë, të dallojnë mes teorive të të nxënit dhe t'i aplikojnë ato. Kjo do të përmirësojë aftësitë e tyre për të evidentuar tipat e nxënësve me të cilët kanë të bëjnë si dhe për t'u transmetuar atyre sa më lehtë njohuritë gjuhësore duke përdorur aktivitete të nxëni autentike, të bazuara në kontekst; duke vënë në pyetje dhe duke reflektuar mbi mënyrën e tyre të të nxënit për të kuptuar larmishmërinë e mënyrave si mësojmë